Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1022

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Megadolon SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me gypa të plastikës, brryla, koka dhe fllansha" me numër të prokurimit; KEK-23-9146-1-2-1, me, 20/03/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Megadolon" SH.P.K. me nr. 2023/1022, e datës 18/12/2023, kurse vendimi i autoritetit kontraktues, Korporata Energjetike e Kosoves, sh.a, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me gypa të plastikës, brryla,koka dhe fllansha" me numër të prokurimit; KEK-23-9146-1-2-1, anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Ri-vlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, Autoriteti kontraktues duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës OE ankus, sipas nenit 31.4 dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.08.2023, Korporata Energjetike e Kosoves sh.a., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me gypa të plastikës, brryla, koka dhe fllansha" me numër të prokurimit KEK-23-9146-1-2-1. Ndërsa me datën 01.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 06.12.2023, OE "Megadolon SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 08.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për

rishqyrtim.

Me 18.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Megadolon SH.P.K, me nr. 2023/1022 lidhur me aktivitetin "Furnizim me gypa të plastikës, brryla, koka dhe fllansha" me numër të prokurimit KEK-23-9146-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE Megadolon SH.P.K, janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se "AK gjatë rivlerësimit te tenderit, Vendimin e AK dhe LS dt. 01.12.2023 ka bere shkelje te neneve te LPP-se Nr-04/L-042 dhe atë te nenit 6, 7, 59, 60, 69 .Neni 6 – Me te cilin te gjitha Autoritetet kontraktuese janë te obliguara qe te sigurojnë fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyre ekonomike, njëkohësisht duke marre për baze qëllimin. AK KEK SH.A ka bere shkeljen e këtij neni sepse duke u bazuar ne ofertën e OE ADE Group SHPK e cila është teknikisht dhe administrativisht e pa përgjegjshme e ka rekomanduar për kontratë edhe pse është oferte me çmimin me te larte e pa përgjegjshme duke mos zbatuar parimin e ekonomictitetit sipas këtij neni te LPP-se se Kosovës. Është Shkelur neni 7 pika 1. e këtij neni te LPP-se Barazia ne Trajtim / Jo-Diskriminim 1.Autorititeti Kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabartë dhe jo diskriminuese te cilën komisioni gjate vlerësimit nuk e ka zbatuar këtë nen duke na dëmtuar neve si OE dhe AK duke propozuar për kontratë OE ADE GROUP shpk si ofertë me çmimin me te larte te pa përgjegjshëm teknikisht dhe administrativisht. Është shkelur neni 59 I LPP-se AK KEK – sha. Gjate vlerësimit ka shkelur këtë nen duke mos bere vlerësimin e tenderit ne mënyrë profesionale nga aspekti teknik as administrativ, bazuar ne dokumentacionin e prezantuar te OE ADE GROUP shpk te rekomanduar për kontrate I cili rekomandim është plotësisht I pa drejte sepse është I pa përgjegjshëm teknikisht dhe Administrativisht. Është shkelur neni 60 I LPP-se Kriteret për dhënien e Kontratës 1.Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik qe ka dorëzuar ose 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin me te ultë 1.2 tenderin ekonomikisht me te favorshëm ne baze te kritereve dhe peshën qe është specifikuar ne dosjen e tenderit sipas nenin paragrafit 3. Te nenit 52 te këtij ligji. AK nuk i ka respektuar asnjë pike te këtij neni sepse ka prezantuar OE ADE GROUP SHPK për kontrate i cili nuk e plotëson asnjërën nga këto kritere te këtij neni. Është Shkelur neni 69 – Te Aftësia Teknike dhe Profesionale Është shkelur ky nen sepse AK gjate procesit te vlerësimit nuk është bazuar ne dokumentacionin e paraqitur te OE te propozuar për kontrate , ku sipas dokumentacionit te paraqitura ne oferte shifet se ai nuk i ka plotësuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale siç janë kërkuar ne FDT pika 9.1&9.2 si dhe kriteret e obligueshme teknike ne ANKES 1 te DT.

Pretendimi i parë (I) - Ankuesi pretendon se "Janë bere këto shkelje: a. Neni 9.1&9.2 I DT pika 2.1 është kërkuar: Dokumentacioni Autentik i prodhuesit si kataloge pjese te katalogut nga prodhuesi dhe apo vizatime te vërtetuara nga prodhuesi me përshkrime teknike detale për artikujt qe ofertoni Gjithashtu është kërkuar qe gypat dhe brrylat nga poz 1-10 duhet te jene sipas vizatimeve te AK OE ka ofruar katalogje te nënvizuara te cilat nuk janë ne përputhje me specifikimin teknik te FDT , Oe I propozuar për kontrate ka prezantuar për poz 1-6 katalogje dhe vizatime JO autentike por ka ndërhyrje ne Vizatimet e AK duke I vendosur logon e prodhuesit si te vetin (prodhues) e cila ndërhyrje konsiderohet e falsifikuar ,SHIQO Dokumentin 1."

Pretendimi i dytë (I) - Ankuesi pretendon se "Aneksi 1. FTD Specifikimin teknik , deklaratën mbi origjinën dhe përshkrimin e çmimeve te OE I propozuar për kontrate e ka plotësuar si prodhues për te

gjitha pozicionet gypa, fllansha dhe kokat se prodhues është Gemaplast duke mos prezantuar katalog apo vizatim te GEMAPLAST për fllansha te metalit dhe koka edhe pse nuk I prodhon ato por OE ADE GROUP SHPK e ka prezantuar si prodhues te tyre dhe vendi I origjinës e ka prezantuar për fllansha metalike dhe koka qe është Maqedonia e Veriut sepse ai prodhon vetëm gypat e plastikes ku nuk dëshmohet se I prodhon edhe fllanshat e metalit dhe kokat e plastikes ,Argument nga certifikata ISO 9001:2015 ku shihet se ky prodhues është vetëm I gypave te plastikes dhe, Prodhues i Fllanshaave te metalit dhe kokave te plastikes është ELBOR TURQI. Karakteristika teknike te artikujve te cilat i ka ofruar OE i propozuar për kontrate nuk janë sipas specifikimeve teknike te dosjes se tenderit .Shiqo dokumentin nr .2."

Pretendimi i tretë (I) - Ankuesi pretendon se "Poz.11 Koka për gyp atë plastikes o 225 , Oe ka ofruar 21.6m është kërkuar trashësia 20.5mm OE e ka ofruar me gjatësi 196mm është kërkuar koka me gjatësi 200mm ka ofruar dimezion 196mm , dimensioni I kërkuar është 200mm Poz.12 – Koka për gyp atë plastikes o 250 , ka oferuar kokën me trashësi 23.5mm është kërkuar koka me trashësi 22.7mm Poz.13- Fllansha te celikta për gyp atë plastikes o 225mm ka ofruar o238 mm eshte kerkuar fllansha o245 mm është kërkuar fllansha me trashësi 20mm, ka ofruar 24mm Poz.14 Fllansha te çelikta për gyp atë plastikes o 250mm ka ofruar o350mm është kërkuar 4/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim te vendimit ne AK fllansha o352mm Është kërkuar fllasha me trashësi 25mm ka ofruar 26mm Te gjitha keto dimensione ofertuesi I rekomanduar për kontrat I ka ofruar duke I prezantuar te nënvizuara ne katalogun e prezantuar te prodhuesit me dimensione te gabuara ."

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2023/1022 ndërsa me datë 12.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1022 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues- Teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertin shqyrtues duke theksuar "OE i shpallur i përgjegjshëm nga ana e AK "A-D-E Group", për të gjitha pozicionet, prodhuesi Elbor Makine i ka të vulosura vizatimet e dosjes së tenderit, sipas vlerësimit tonë kjo dëshmon se prodhimet do të sillen sipas vizatimeve në DT të vulosura nga prodhuesi Elbor Makine, këtë e dëshmon edhe Autorizimi i arritur mes palëve Gema Plast, Elbor Makine dhe OE konkurrues "A-D-E Group". Prodhimet e këtyre prodhueseve janë liferuar edhe më parë në TC/B dhe nuk ka asnjë vërejtje për cilësinë e tyre. Eksperti shqyrtues siç duket është bazuar ne raportin paraprak dhe jo atë te ri-vlerësimit. Për korrektësi, komision i vlerësimit të gjithë OE konkurrues të cilët kanë konkurruar me prodhime të prodhueseve Gema Plast dhe Elbor Makine i ka konsideruar të përgjegjshëm, për shkak se deri me tani këto prodhime te këtyre prodhueseve janë treguar cilësore gjatë operimit dhe i plotësojnë ne përgjithësi kërkesat teknike. Qëllimi i OE ankues është vetëm te dëmtohet procesi i tenderimit pasi qe ne ankesën e këtij OE nuk ka asnjë pretendim se AK ka bere shkelje ne eliminimin ofertës se tij si oferta me e lire dhe as ndaj OE tjerë qe kane qene me prodhime te njëjta sikurse OE i rekomanduar për dhenje", ndërsa OE nuk është deklaruar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues.

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1022, të pretendimeve ankimore të OE ankues, si në vijim;

Konstatimi i parë (I) – Eksperti sqaron se "OE ankues Megadolon SHPK pretendon se nga ana e OE të rekomanduar OE ADE GROUP SHPK, nuk janë plotësuar kërkesat për mundësitë teknike dhe/ose profesionale në pikat 9.1 dhe 9.2 të DT. Këto kërkesa përfshijnë certifikatat e produkteve, katalogët apo prezantimet grafike (vizatimet), dhe fotografitë e produkteve, të shoqëruara me përshkrim teknik detajuar për artikujt që ofertohen. Këto duhet të dëshmohen me certifikata, dokumentacion autentik të prodhuesit,

si dhe kataloge dhe/ose vizatime të vërtetuara nga prodhuesi me përshkrim teknik detajuar. OE ankues pretendon se për pozicionet 1-10, kërkesat e DT nuk janë plotësuar dhe pajisjet e ofertuara nuk i përmbushin këto kërkesa. Megjithatë, pas administrimit të dokumentacionit dhe katalogut për pozicionet 1-10, konstatohet se për pozicionin e gypave, OE i rekomanduar ka prezantuar gypa nga kompania Gemaplast-tim, të cilat plotësojnë kërkesat teknike të definuara në ANEKS1, duke përfshirë vizatimet me dimensione, të tipit SRD11 dhe me drashesinë e mureve në përputhje me kërkesat e ANEKS1. Ndërsa, brrylat e tipit 45 dhe 90 shkallë janë nga kompania Elbor dhe po ashtu plotësojnë kërkesat sipas ANEKS1 dhe vizatimeve, duke përfshirë trashësinë e mureve dhe dimensionet sipas kërkesave në DT. Lidhur me këtë pretendim, bazuar në sqarimin e dhënë më lart, eksperti teknik mendon se pretendimi ankimor është i PABAZUAR."

Konstatimi i dytë (II) – Eksperti sqaron se "Në lidhje me autentifikimin e dokumentacionit të prezantuar nga ana e OE të rekomanduar, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar në ofertën e OE të rekomanduar, mund të thuhet se OE i rekomanduar ka paraqitur një dokument (katalozi i certifikati.pdf) që paraqitet si një katalog i përbërë nga dokumentacioni i dy prodhuesve të ndryshëm, por pa vërtetim nga ana e prodhuesit. Dokumentet e tjera, të cilat janë prezantuar si dokumentacion për vizatime teknike (drawings.pdf) të produkteve, janë ndërtuar duke i vënë logon e njërit nga prodhuesit (Gemaplast-tim), gjë që nuk përputhet me kërkesën e DT, ku është kërkuar që OE të prezantojë dokumentacion të vërtetuar nga prodhuesi me përshkrim teknik për produktet e ofertuara. Mbi të gjitha, lidhur me specifikimin e origjinës së pajisjeve, siç është kërkuar në ANKES1, konform dokumentacionit të prezantuar, shihet mos-përputhje mes dokumenteve të prezantuara në ofertë, katalog dhe specifikacion teknik (S.TEKNIK.pdf), ku në katalog duket se kemi të bëjmë me prodhues të ndryshëm, ndërsa tek specifikacioni teknik nga ana e OE të rekomanduar është prezantuar vetëm një, duke përcaktuar vetëm Gemaplast-tim si vendin e origjinës së produkteve. Prandaj, bazuar në këtë çështje, eksperti teknik mendon se pretendimi ankimor është i BAZUAR."

Konstatimi i tretë (II) – Eksperti sqaron se "Sa i përket pretendimit ankimor se OE i rekomanduar ka paraqitur produkte me anë të katalogeve që nuk plotësojnë kërkesat e DT dhe nuk përputhen me kërkesat e vizatimeve teknike (9.1 dhe 9.2) të kërkuara në ANKES1 dhe vizatimeve teknike në DT, pas shqyrtimit të specifikacioneve teknike të pajisjeve të prezantuara në ofertë shihet se kemi mos përputhje në mes kërkesave të DT dhe pajisjeve të ofertuara një gjë e tillë është skjaruar edhe në raportin e komisionit të vlerësimit të bërë nga ana e AK, OE i rekomanduar nuk ka prezantuar produkte që plotësojnë kërkesat për pozicionet 11, 12, 13 dhe 14, të kërkuara me anë të vizatimeve teknike. Prandaj, bazuar në shqyrtimin e mësipërm, pretendimi ankimor i OE ankues kundrejt vendimit të AK vlerësohet si i BAZUAR." (Eksperti shqyrtues, sqaron se përgjigjet ne pretendime ankimore janë dhënë nga Eksperti teknik.)

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me gypa të plastikës, brryla, koka dhe fllansha" me numër të prokurimit KEK-23-9146-1-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Megadolon" SH.P.K dhe argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Megadolon" SH.P.K janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin, faktet e lartë përmendura, ankesën e operatorit ekonomik ankues, dokumentacionit të lëndës, pas analizimi te tyre e vlerëson ankesën e operatorit si të bazuar, anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me gypa të plastikës, brryla, koka dhe fllansha" me numër të prokurimit KEK-23-9146-1-2-1, dhe lënda kthehet në Rivlerësim dhe Autoriteti kontraktues, të veproj për evitimin e gjitha shkeljeve ligjores, përkatësisht të pretendimeve ankimore të OE"Megadolon" SH.P.K të vlerësuara si të bazuara/qëndrueshme sipas Raportit të ekspertit shqyrtues, konstatime të cilat janë të mbështetura nga Paneli shqyrtues, me dispozitat ligjore të LPP-së. Autoriteti kontraktues Rivlerësimin duhet ta bëjë gjithnjë bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjes tenderit dhe në LPP respektivisht nenin 59.4 i cili përcakton se Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Autoriteti kontraktues obligohet që në procesin e Rivlerësimit t'i eliminojnë të gjitha këto shkelje ligjore të konstatuara. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP-së dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: "Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një

shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **Megadolon SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: